



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 432, datë 14.10.2020

PËR

KOMANDIMIN E ZNJ.{...} SI NDIHMËSMAGJISTRATE NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 258, datë 23.07.2020, “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, dërguar me Shkresën nr.2246/1 prot., datë 08.10.2020, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Komandimin e gjyqtarës znj.{...} në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
2. Afati i komandimit është tre vjet dhe fillon më datë 20.10.2020.
3. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit.
4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtarës znj.{...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së komanduar znj.{...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR